



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 17 gusht 2020  
Nr. ref.:RK 1603/20

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI210/19**

Parashtrues

**Sabri Ismajli**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-051-2016, të 23 tetorit 2019**

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskrytar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe  
Nexhami Rexhepi, gjyqtar.

### Parashtruesi kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sabri Ismajli, me vendbanim në fshatin Sadovinë e Qerkezëve, Komuna e Vitisë, i cili përfaqësohet nga Sahit Musa, avokat në Viti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kérkesës konteston kushtetutshmérinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-051-2016, të 23 tetorit 2019.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kérkesës pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kérkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridikzioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kérkesës] dhe 47 [Kérkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 22 nëntor 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), pranoi kérkesën e parashtruesit të kérkesës, të cilën e kishte dërguar përmes postës më 20 nëntor 2019.
6. Më 27 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gérxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegin shqyrta, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhami Rexhepi (anëtarë).
7. Më 11 dhjetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kérkesës për regjistrimin e kérkesës dhe kerkoi nga ai të plotësonë formularin si dhe të bashkëngjiste dokumente shtesë. Një kopje të kérkesës, të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 26 dhjetor 2019, parashtruesi i kérkesës dërgoi në Gjykatë kopjen e formularit dhe dokumente shtesë.
9. Më 15 prill 2020, Kolegi shqyrta shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe vendosi që vendimmarrja përkitazi më kérkesën e parashtruesit të kérkesës, të shtyhet për shqyrtim në njëren nga seancat e radhës.
10. Më 15 korrik 2020, Kolegi shqyrta shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmérinë e kérkesës.

## **Përbledhja e fakteve**

11. Më 14 dhjetor 2006, personi R.K., kishte paraqitur kérkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP) duke kerkuar kthimin e posedimit të ngastrës kadastrale nr.856 në Sojevë-Ferizaj në vendin e quajtur

“Kurkulica” [në tekstin e mëtejmi: ngastra kontestuese]. Personi R.K., kishte deklaruar se “*prona ishte humbur për shkak të konfliktit që ka ndodhur në vitin 1998/99 dhe si datë e humbjes kishte cekur 12 qershorin 1999*”.

12. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës dhe katër (4) persona të tjera, kishin paraqitur po ashtu kërkesë para AKP-së lidhur me ngastrën kontestuese. Parashtruesi i kërkesës kishte deklaruar se më 21 qershor 2007 kishte blerë 5/7 e pjesës ideale të ngastrës kontestuese në sipërfaqe prej 3.87.34 ha.
13. Më 21 tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (në tekstin e mëtejmi: KKP) përmes vendimit KPCC/D/A/260/2014, kishte hedhur poshtë kërkesat e lartcekura me arsyetimin se ky kontest binte jashtë juridiksonit të KKP-së pasi që posedimi lidhur me ngastrën e kontestuar nuk kishte humbur si rezultat i konfliktit të vitit 1998/99.
14. Kundër vendimit të lartpërmendur të KKP-së, janë parashtruar dy ankesa në Gjykatën Supreme.
15. Më 20 mars 2015, personi R.K., parashtroi ankesë kundër vendimit të KPCC/D/A/260/2014 të KKP-së në Gjykatën Supreme.
16. Më 21 mars 2016, parashtruesi i kërkesës po ashtu parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, kundër vendimit KPCC/D/A/260/2014 të KKP-së duke kerkuar që ti lejohet që në mënyrë të qetë dhe të papenguar të shfrytëzoj pjesën ideale prej 5/7 të ngastrës së kontestuar.
17. Më 24 janar 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit GSK-KPA-A-266/2015 (në të cilin vendim si palë e kundërt kishin qenë parashtruesi i kërkesës dhe personi Q.R.), kishte refuzuar ankesën e personit R.K. dhe kishte vërtetuar vendimin e KKP-së, me arsyetimin se qëndrimi i KKP-së është i drejtë dhe i bazuar në ligj, sepse KKP sipas nenit 3.1 të Ligjit nr.03/L-079 për ndryshimin e Rregullores nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kérkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (në tekstin e mëtejmi: Ligji nr.03/L-079), ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin që ka ndodhur në vitet 1998/1999. Më tej, Gjykata Supreme duke arsyuar se prona në fjalë nuk është humbur për shkak të konfliktit kishte theksuar se:

*“Kjo do të thotë se fushëveprimi i shqyrtimit të AKP-së është të verifikoj elementet vijuese: kush ka qene në posedim të pronës kerkuar para datës 27 shkurt 1998, kush është në posedim të saj tanë, kur dhe përfshirë arsyet e humbur posedimi gjatë periudhës në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.*

*Nëse Komisioni e vërteton se posedimi i pronës së kerkuar ishte humbur para apo pas datave që cekën më lartë, apo që humbja e posedimit nuk ka pasur të bëjë me konfliktin, ajo hedhë poshtë kérkesën mbi bazën e nenit 11.4(b) te Ligjit nr. 03/L-079.”*

18. Më 23 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit GSK-KPA-A-051-2016, e hedhë ankesën e parashtruesit të kërkesës të ushtruar ndaj vendimit

KPCC/D/A/260/2014, të 21 tetorit 2014 si të pasafatshme. Gjykata Supreme, arsyetoi si në vijim:

*"Ankesa është e paafatshme. Neni 12.1 i ligjit nr. 03/L-079 "Mbi zgjidhjene kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshire pronën bujqësore dhe atë komerciale" (në tekstin e mëtejme "Ligji nr. 03/L-079") përcakton si në vijim: "Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të.' paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.*

*Pala ankuese e ka pranuar personalisht vendimin e KKPK-së me 11 Shkurt 2015, ai kishte paraqitur ankesë me 21 Mars 2016. Kjo do të thotë se ankesaështë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj."*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme GSK-KPA-A-051-2016, atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
20. Parashtruesi i kërkesës thekson se ai ka përpiluar një kontratë për shitblerjen e pronës me personin T.S. Lidhur me këtë kontratë me personin T.S. parashtruesi i kërkesës pohon se ngastrën "nr.856 dhe atë 5/7 [...] të pjesës ideale në vendin e quajtur Kurkulicë me kultur arë e klasit të 6 në sip. prej 54.22,83ha, [personi T.S.] ja ka shitur [parashtruesit të kërkesës], të cilën paluajtshmëri e ka blerë me çmimin e shitblerjes në vlerë prej 4950 euro të cilin çmim blerësi e ka paguar në momentin e arritjes së marrëveshjes dhe është sjellur blerësi në posedim shfrytëzim dhe pronësi të vet dhe të njëjtit kontraktues janë marruar vesh në mes veti qe kjo kontratë mos të prishet në çfarëdo baze juridike".
21. Parashtruesi i kërkesës thekson se "Kohëve të fundit disa qytetar përkatesisht R.K., [...] pretendon se kjo pronë është e tij". Lidhur me personin R.K., parashtruesi i kërkesës pohon se ka informacion se i njëjti nuk jeton më dhe veprimet që janë duke u ndërmarrë në emër të R.K., parashtruesi i konsideron të pabazuara.
22. Parashtruesi i kërkesës konsideron se prona kontestuese nuk është humbur gjatë konfliktit në vitin 1998/1999, por pronën e ka blerë në bazë të kontratës së 26 qershorit 2007 nga pronari T.S., kontratë kjo e vërtetuar më 6 korrik 2007 në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
23. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për mbrojtje të pronës sepse këtë pronë e ka blerë nga "pronari legitim T.S.".
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykit të Gjykatës Supreme, duke e konsideruar se i njëjti ka shkelur të drejtën e parashtruesit për mbrojtje të pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.

## Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
- [...]
- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
27. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

### Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

### Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

### Neni 49 [Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. [...].”*

28. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (b) [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 39  
[Kriteret e pranueshmërisë]

“1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

*(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”*

29. Për sa i përket përbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik përkatësisht Aktgjykimin [GSK-KPA-A-051-2016] të 23 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme.
30. Në vazhdim, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka shterur mjetet juridike ashtu si kërkohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
31. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
32. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, *inter alia*, *Aksoy kundër Turqisë*, parografi 51 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 18 dhjetorit 1996).
33. Ky parim nënkupton se mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parografi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976).
34. Megjithatë, sipas praktikës së GJEDNJ-së, përderisa detyrimi për shterjen e mjeteve juridike duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar, ky detyrim nuk kërkon thjeshtë vetëm që kërkesat të parashtrohen para gjykatave të rregullta por kërkon po ashtu që parashtruesi i kërkesës para se të paraqesë kërkesën, që ka për qëllim që pastaj ta paraqesë para GJEDNJ-së, duhet: a) ti ketë ngritur të njëjtat pretendime para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë; dhe b) të ketë respektuar kërkesat formale dhe afatet e parapara me legjislacionin në fuqi (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së: *Gäfgen kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 1 qershorit 2010, parografi 142; *Kunert kundër Polonisë*, Aktgjykim i 4 korrikut 2019, parografi 42; dhe *Gadd kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i 28 shtatorit 2017, parografi 54).

35. Sa i përket pikë a) të cekur më lart, që parashtruesi ti ketë ngritur të njëjtat pretendime para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë para se ti drejtohet Gjykatës, Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshmëm nga Gjykata Kushtetuese nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljen e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Mosshfrytëzimi i kësaj mundësie do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. (Shih, rastet e Gjykatës KI68/16, *Fadil Rashiti*, Aktvendimin për papranueshmëri i 31 marsit 2017, paragrafi 38, dhe KI139/12, *Besnik Asllani*, Aktvendimin për papranueshmëri i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 152).
36. Ndërsa, , sa i përket kriterit b) që parashtruesi të ketë respektuar kërkesat formale dhe afatet e parapara me legjislacionin në fuqi para se ti drejtohet Gjykatës, sipas praktikës gjyqësore të GEDNJ ka theksuar se mjetet juridike nuk janë shterur në rastet kur ankesa nuk është pranuar për shqyrtim nga gjykatat e rregullta për shkak të lëshimeve procedurale të parashtruesit të kërkesës (shih në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së: *Gäfgen kundër Gjermanisë*, cekur më lart, paragrafi 143; *Kunert kundër Polonisë*, cekur më lart, paragrafi 42; dhe *Gadd kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cekur më lart, paragrafi 54).
37. Për më tepër, sa i përket pikë b) të cekur më sipër, GJEDNJ ka theksuar se rregullat që përcaktojnë hapat procedural që kërkohet të ndërmerren dhe afatet kohore të cilat duhet të respektohen sa i përket paraqitjes së ankesës janë krijuar për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe pajtueshmërinë, veçanërisht, me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e GJEDNJ *Ben Salah Adraqui and Dhaime kundër Spanjës*, Vendim i 27 prillit 2000).
38. Në këtë kontekst, në rastin *Ben Salah Adraqui and Dhaime kundër Spanjës*, cituar më lart, GJEDNJ kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shterur mjetet juridike të cilat i kishte në dispozicion para institucioneve vendore, për shkak të paraqitjes së ankesës para Gjykates Kushtetuese të Spanjës, pas afatit të paraparë me ligj. Rrjedhimisht, GJEDNJ kishte dekluaruar kërkesën e tij si të papranueshme për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike sipas nenin 35 të KEDNJ.
39. Në rastin *Kunert kundër Polonisë*, cituar më lart, parashtruesi kishte ngritur padi civile duke këruar kompensim për mbajtjen e tij në paraburgim në qendra të mbajtjes të cilat ishin të stërngarkuara. Pasi kërkesa e tij ishte refuzuar, ai kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut. Kjo ankesë ishte refuzuar pasi ai kishte paraqitur vetëm një kopje të ankesës dhe nuk kishte paraqitur kopjen e dytë të saj, përkundër kërkesës së gjykates që kishte rastin nën shqyrtim. Andaj, GJEDNJ, pasi adresoi kërkesën specifike të parashtruesit lidhur me cenimin e të drejtës për qasje në drejtësi si të pabazuar, kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 3 (Ndalimi i torturës) për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike, pasi parashtruesi, megjithëse formalisht kishte ndjekur procedurat gjyqësore përmes ankesës

lidhur me kompensimin për mbajtjen e tij në paraburgim në qendra të stërngrakuara, ankesa e tij ishte refuzuar nga gjykatat e rregullta pasi ai kishte dështuar t'i plotësojë kërkesat procedurale, respektivisht që të dorëzojë kopjen e dytë të një ankesë të paraqitur më herët nga ai, ashtu si ishte kërkuar nga gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, GJEDNJ kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit lidhur me nenin 3 (Ndalimi i torturës) pasi kishte konsideruar se ankesa e parashtruesit ishte refuzuar nga gjykatat e rregullta për arsy procedurale të shkaktuara si rezultat i gabimeve të vet parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht ai nuk i kishte shtetur mjetet juridike sipas nenin 35 të KEDNJ.

*Lidhur me shterimin e mjeteve juridike në rastin konkret*

40. Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përbushur kriteret e shterimit të mjeteve juridike, sipas standardeve të përcaktuara më lart, respektivisht nëse ai ka respektuar kërkesat procedurale në mënyrë që institucionet kompetente dhe gjykatat e rregullta të mund të trajtojnë pretendimet e tij lidhur me të drejtën e pronës për ngastrën e kontestuar, konkretisht vlerësimin e kontratës së shitblerjes lidhur me pronën e kontestuar nga KPKP dhe Gjykata Supreme.
41. Lidhur me këtë Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e konteston para Gjykatës procedurën e ndjekur nga Gjykata Supreme lidhur me Aktgjykimin GSK-KPA-A-051-2016 të 23 tetorit 2019, sa i përket afatshmërisë së ankesës të paraqitur para Gjykatës Supreme, por konteston faktin që Gjykata Supreme nuk kishte marrë parasysh kontratën e shitblerjes së pronës, përkatësisht faktin se parashtruesi i kërkesës këtë pronë e ka blerë nga “*pronari legjitim*”, përkatësisht personi T.S. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se si rezultat i kësaj, atij i është shkelur e drejta kushtetuese për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës.
42. Parashtruesi i kërkesës përkundër faktit që Gjykata Supreme nuk kishte trajtuar ankesën e tij ndaj vendimit të KPKP-së, pasi ankesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, kërkon nga Gjykata që të vlerësojë kontratën e shitblerjes me personin T.S. dhe të konstatojë se ai gëzon të drejtën e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës lidhur me këtë pronë.
43. Me këtë rast, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [GSK-KPA-A-051-2016] të 23 tetorit 2019, e ka hedhur ankesën e parashtruesit të kërkesës të ushtruar ndaj vendimit të KPKP-së [KPCC/D/A/260/2014], të 21 tetorit 2014 si të pasafatshme. Gjykata Supreme, me këtë rast i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës se neni 12 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-079, parashëh periudhën prej tridhjetë (30) ditësh për paraqitjen e ankesës në Gjykatën Supreme. Andaj Gjykata Supreme theksoi se parashtruesi i kërkesës, ka paraqitur kërkesën jashtë afatit sepse vendimin e KPKP-së [KPCC/D/A/260/2014] e kishte pranuar më 11 shkurt 2015 ndërsa ankesën e kishte parashtruar më 21 mars 2016.
44. Në fakt, Gjykata përsërit se as Gjykata Supreme e as KPKP, nuk janë lëshuar në vlerësimin e kontratës së shitblerjes ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personit T.S., sepse KPKP-ja kishte hedhur kërkesën me arsyetimin se binte jashtë juridiksionit të KPKP-së sipas nenit 3.1 të Ligji nr.03/L-079, ndërsa Gjykata Supreme kishte vendosur se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte e

paafatshme. Këto gjetje të Gjykatës Supreme parashtruesi fare nuk i konteston para Gjykatës.

45. Gjykata vëren se, Gjykata Supreme nuk kishte mundësi të trajtonte pretendimin e parashkruesit të kërkesës se pronën e kontestuar ai e ka blerë nga “*pronari legitimus*”, përkatësisht personi T.S. dhe si pasojë atij i është shkelur e drejta e tij kushtetuese për mbrojtje të pronës siç garantonohet me nenin 46 të Kushtetutës, për shkak të mos respektimit të hapave procedural ashtu si parashihet me ligj, përkatësisht për shkak të paraqitjes së ankesës jashtë afatit ligjor. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës, megjithëse e kishte ngritur si pretendim, ai kishte humbur mundësitë e tij procedurale që përmes kësaj procedure të dëshmonte pretendimet e tij për pronësinë për ngastrën e kontestuar.
46. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës për shkelje të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, edhe pse ai formalisht ka ndjekur procedurat gjyqësore për të kontestuar vendimin e KPPK-se, nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë para Gjykatës, pasi që parashtruesi nuk i ka shterur mjetet juridike lidhur me shkeljet e pretenduara për shkelje të të drejtës në pronë, për shkak të lëshimeve të tij procedurale fillimisht para KPPK-së e pastaj para Gjykatës Supreme.
47. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë para Gjykatës pasi që nuk janë shteruar mjetet juridike siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b), të Rregullores së punës, më 15 korrik 2020, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvete Gërxhalia-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi